REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE

KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

**Nr. 9/2023 (JR)** **Tiranë, më 11 .06.2025**

**Nr. 9/2 regj.**

**SHPALLJE**

**E**

**NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se **ditën e enjte, datë 03.07.2025, ora 10:00**, do të gjykohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit me numër regjistri (JR) 09/2023, datë 27.02.2023, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Andri Ymeri kundër vendimit nr. 604, datë 21.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

| | |
|---|---|
| **Kryesuese e Trupit Gjykues** | **Albana Shtylla** |
| **Relatore e Çështjes** | **Mimoza Tasi** |
| **Gjyqtare** | **Rezarta Schuetz** |
| **Gjyqtare** | **Natasha Mulaj** |
| **Gjyqtare** | **Ina Rama** |

Bazuar në nenin 49 pika 2 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrimet me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim. Bazuar në nenin 482 paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu dhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES**

**GJYQTARE**

**ALBANA SHTYLLA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT TIRANË SEKRETARIA GJYKATA KUSHTETUESE

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë, e-mail: info@kpa.al ; www.kpa.al